



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 17.12.2019

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

**PËR AKTIN NORMATIV NR. ____ DATË 17.12.2019 "PËR PËRDORIMIN E
PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR SUBVENCIONIMIN E PAGESËS SË
QIRASE SË BANËSËS PËR FAMILJET E MBETURA TË PASTREHA, SI
PASOJË E FATKEQËSISË NATYRORE, TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019"**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17.12.2019, mori në shqyrtim Akti Normativ nr. datë 16.12.2019 "Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirase së banësës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019", bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Blerina Gjylameti.

Për të prezantuar projektligjin në emër të Qeverisë, ishin të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Akti normativ është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normative.

Qëllimi

Në kuadër të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës Tiranë dhe Lezhë, me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, i ndryshuar, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, familjeve të viktimave do t’u ofrohet subvencionimi i qirasë për një vit, sipas procedurave të përshpejtuara. Akti normativ propozohet për shkak të nevojës që lind për të kapërcyer disa procedura, afate kohore dhe dokumente standarde, që kërkohen nga ligji nr.22/2018, “Për strehimin social” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Përmbajtja e aktit normativ

Akti normativ “Për subvencionimin e qirasë me procedura të përshpejtuara për familjet që kanë ngelur të pastreha, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019” përbëhet nga 9 (nëntë) nene.

Në nenin 1, parashikohet masa e subvencionimit të qirasë për familjet, subjekt i këtij akti, i cili përcaktohet në masën 100% të nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë.

Në nenin 2 parashikohen detyrimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore për:

- i. hartimin e listave të familjeve që do të përfitojnë subvencionimin e qirasë;
- ii. vlerësimin e nivelit mesatar të qirasë të banesave në treg në njësinë e vetëqeverisjes vendore (nëse nuk e kanë bërë një gjë të tillë në zbatim të ligjit nr.22/2018; paraqitjen e listës së përfituesve për miratim në këshillin bashkiak dhe; dërgimin e kërkesës për mbështetje buxhetore në ministrinë përgjegjëse për strehimin.

Neni 3 parashikon dokumentacionin që duhet të paraqesë familja në mënyrë që të përfitojë subvencionimin e qirasë. Në listën e dokumenteve përfshihen vetëm:

- i. formulari, i cili përmban të dhëna identifikuese për familjen, banesën e prishur/të pabanuar dhe aktin e verifikimit;
- ii. akti i konstatimit i hartuar nga Instituti i Ndërtimit;
- iii. certifikata e gjendjes familjare, në bazë të së cilës NJVV llogarit shumën e subvencionit dhe;

iv. numrin e llogarisë bankare ku do të derdhet subvencioni.

Neni 4 parashikon rastin kur banesa e dëmtuar ndodhet në një qytet ndërsa familja gjen banesën që do të marrë me qira në një qytet tjetër, duke lejuar dhënien e subvencionimit edhe në këtë rast.

Neni 5, parashikon mënyrën e ndarjes së fondeve të buxhetit nga ministria përgjegjëse për strehimin, duke iu referuar proporcionalitetit në ndarjen e fondeve, bazuar në numrin e familjeve, banesat e të cilave janë dëmtuar si edhe në mundësitë financiare të bashkisë për të financuar me të ardhurat e veta.

Neni 6 përcakton rastet përjashtimore të parashikuara, përkatësisht:

- kategoritë prioritare të përcaktuara në nenin 34, i cili nuk e përcakton këtë kategori prioritare
- dhënien e subvencionit drejtpërdrejt në llogari të pronarit sipas nenit 37, ndërkohë që akti normative parashikon ti akordohet në llogari të familjes përfituese. Gjithashtu për familjet që përfitojnë subvencionimin e qirasë sipas ligjit 22/2018, familja duhet të ketë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar, ndërkohë që aktit normativ nuk kërkohen të dhëna mbi nivelin e të ardhurave
- neni 39 i ligjit përcakton afatet, procedura dhe dokumentacionin për të përfituar subvencion, ndërkohë që akti normative i ka anashkaluar ato.

Neni 7 përcakton se, subvencionimi i qirasë sipas këtij akti normative ka vlerë vetëm për një periudhë një vjeçare. Më pas, familjet që rezultojnë ende të pasistemuara me forma të tjera strehimi, do të duhet të aplikojnë me dokumentacionin përkatës, sipas kërkesave ligjore të ligjit nr.22/2018.

Neni 8 parashikon burimin e financimit të subvencionimit të qirasë. Burimi kryesor do të jetë buxheti i shtetit. ndërkaq, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në mundësitë e tyre financiare, mund të kontribuojnë. Kështu p.sh., për bashkinë e Tiranës kontributi i buxhetit të shtetit do të jetë komplementar i buxhetit të bashkisë. Ndërkohë, bashkitë e tjera janë në pozicion më të disfavorshëm dhe nuk pritët kontribut i ndjeshëm.

Neni 9, ngarkon njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministrinë përgjegjëse për strehimin për zbatimin e aktit normative.

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij akti normativ janë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për strehimin.

IV. Efektet financiare

Vlerësohet se subvencionimi i qirasë për një vit për rreth 6000 familje të jetë rreth 1 miliard lekë dhe do të përballohen kryesisht nga buxheti i shtetit.

Akti Normativ nuk parashikon shpenzime shtesë për burimet njerëzore pasi procedurat do të ndiqen nga strukturat / stafet ekzistuese të NJVV.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij u shpreh se miratimi i këtij akti normativ është diktuar në kuadër të masave që po merr qeveria për t'u ardhur në ndihmë të familjeve, banesat e të cilave, si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, janë shembur ose janë deklaruar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit.

Subvencionimi i qirasë është një instrument financiar që i jep zgjidhje të shpejtë situatës së strehimit të familjeve që kanë ngelur të pastreha si rezultat i fatkeqësisë natyrore. Sipas informacionit të datës 4.12.2019 nga Dispeceri (burimi i informacionit nga media) rezultojnë:

- Shtëpi të shembura: 1183 (Durrës 1050, Tiranë 131, Dibër 2)
- Shtëpi të dëmtuara rëndë: 5514 (Durrës 3838, Tiranë 1311, Lezhë 168, Kukës 150, Dibër 13, Elbasan 34)
- Pallate të dëmtuara rëndë: 558 (Durrës 35, Tiranë 461, Lezhë 56, Kukës 4, Dibër 1, Elbasan 1)
- Pallate të pabanueshme: 20 (Tiranë)

Lista e plotë pritet të përditësohet, por sipas të dhënave të mësipërme rezultojnë rreth 6,697 familje në banesa, ndërkohë që numri i familjeve që banojnë në pallatet e dëmtuara rëndë dhe ato që janë shembur nuk është i raportuar.

Subvencionimi i qirasë është një instrument financiar i parashikuar në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social". Procedurat e dhënies së subvencionimit të qirasë në favor të familjeve përfituese nga njësitë e vetëqeverisjes, vendore afatet kohore dhe dokumentacioni që ato duhet të dorëzojnë në njësitë e qeverisjes vendore si edhe procedurat që njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë për të përfituar mbështetje nga buxheti i shtetit, kur ato nuk disponojnë të ardhura të mjaftueshme, janë përcaktuar pjesërisht në ligj dhe më pas, detajuar me akte nënligjore të cilat janë miratuar këtë vit.

Ky akt normativ, synon të shkurtojë procedurat, afatet kohore dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet përfituese si edhe bashkitë për të përfituar mbështetje buxhetore, duke shmangur disa parashikime të ligjit nr. 22/2018 (nenet 35, 37, 39)

Arsyetimi i nevojës dhe urgjencës.

Kjo nismë ligjore e Qeverisë, është ndërmarrë për shkak të situatës së krijuar pas tërmetit 6.4 të shkallës Rihter, që goditi Shqipërinë në datën 26.11.2019, dhe në kushtet kur Qeveria përmes vendimit nr.750, datë 27.11.2019, ka shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë, të cilat janë edhe qarqet e prekura nga kjo fatkeqësi natyrore.

Akti normativ është në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka vlerësuar mundësinë e prezencës së rrethanave specifike të “nevojës” dhe “urgjencës”, duke përcaktuar se: *“Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.”*

Miratimi i aktit normativ, nga Këshilli i Ministrave, ka shkurtuar së ndjeshmi kohën e ndërhyrjes së qeverisë në ndërmarrjen e masave për përballimin e situatës në të cilën ndohemi aktualisht. Në rast se nisma do të paraqitej si një projektligj i propozuar nga Këshilli i Ministrave, në rrugë normale, koha në dispozicion të Kuvendit për ta miratuar atë si dhe procedurat e mëtejshme të parashikuara në Kushtetutë për miratimin dhe hyrjen në fuqi të aktit do të vononin së tepërmi ndërmarrjen e masave emergjente dhe të nevojshme për qytetarët.

Diskutimet në komision

Pas dëgjimit të relatorit të çështjes dhe shpjegimeve të dhëna nga Ministri i Financës dhe Ekonomisë, anëtarët e komisionit, shprehën vlerësimin e tyre lidhur me aktin normativ dhe domosdoshmërinë për mundësimin sa më shumë të jetë e mundur të lehtësirave si dhe gjetjes së mënyrave dhe lehtësive fiskale që ndikojnë në rehabilitimin e pasojave të tërmetit. Përmes kësaj akti do të mundësohet subvencioni i pageswss së qirasw për 6000 familje.

Kjo iniciativë është në përputhje edhe me frymën e transmetuar përmes nenit 59 të Kushtetutës lidhur me objektivat social të tij.

VI. Përfundime

Për gjithë sa më sipër analizova, duke vlerësuar se miratimi i këtij akti normativ, ishte nevojë dhe urgjencë e Qeverisë për mundësimin e njw kuadri tw nevojshëm ligjor, që do të mundësojë ofrimin e subvencionimit të qirasë për një vit, sipas procedurave të përshpejtuara familjeve të viktimave, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi aktin normativ "Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirase së banësës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019".

RELATOR

KRYETAR

Blerina GJYLAMETI

Arben AHMETAJ